

VENDIM
Nr. 168, datë 26.10.2017

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E ERE-S NR. 103, DATË 23.6.2016, “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. të shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 22112 prot., datë 4.10.2016, ka mbërritur në ERE kërkesa e OSHEE sh.a. për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, mbi miratimin e “Rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. të shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- Mbështetur në nenin 19, germa “I”, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE miraton, me propozim të të licencuarve, rregullat për: “i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik; ii) sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes.

- ERE miratoi vendimin nr. 169, datë 31.10.2016, “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- ERE me shkresën nr. 771 prot, datë 2.11.2016, i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE sh.a., OST sh.a., KESH sh.a., Autoritetit të Konkurrencës, AAES, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, dhe ka kërkuar opinionet e tyre në lidhje me ndryshimet e propozuara nga OSHEE sh.a.

- Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike AAES, me shkresën nr. 18 prot., datë 17.11.2016, propozon që në rast të amendimit të nenit 20 të kësaj rregulloreje, në lidhje me faturimin dhe pagesat, palët të zbatojnë dispozitat e nenit 13 të kontratës EFET.

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën me nr. 8789/1 prot., datë 21.11.2016, bën të ditur se nuk e sheh përfshirjen e kësaj shoqërie në këtë rregullore.

- Autoriteti i Konkurrencës bën me dije se, ndryshimet e propozuara nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 9121 prot., datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në korrespondencë elektronike zyrtare, protokolluar në

ERE më nr. 642/1 prot., datë 13.10.2017, është shprehur se është e nevojshme që neni 20 i kësaj rregulloreje të ketë parashikime në lidhje me afatin e pagesave të tilla që të reflektojnë kostot financiare efektive të kompanisë.

- OSHEE sh.a nga ana e saj ka sqaruar se afati i faturimit të pagesave duhet të ndryshojë nëse ky nen qëndron në rregullore duke e çuar në 90 ditë.

- Me vendimin nr. 122, datë 8.8.2017, të bordit të ERE-s, është vendosur që rregullorja e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. të shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, hyn në fuqi brenda datës 30.9.2017.

- OSHEE sh.a. ka garantuar se procedurën për blerjen e energjisë në treg të parregulluar për muajin nëntor 2017 do ta zhvillojë nëpërmjet platformës *online* të blerjes së energjisë.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Neni 20 i Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, ndryshon si më poshtë:

a) I gjithë procesi i rakordimit të sasive të energjisë elektrike të livruar mes palëve, vlerave përkatëse financiare, si dhe faturimi duhet të mbyllet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e fundit e livrimit të energjisë elektrike. Pagesa do të bëhet nga blerësi brenda 90 ditëve nga dita e fundit e livrimit.

b) Çdo ditë ose periudhë livrimi më e vogël se kaq, në rast se periudha e livrimit për blerjen është më e shkurtër, duhet të jetë e paraqitur si zë më vete në faturë. Faturimi do të gjenerohet nga platforma IT e ngritur nga shitësi që kryen procedurat e shitjes së energjisë elektrike sipas kësaj rregulloreje, dhe do t'i faturohet blerësit.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti